



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2021

**VENDIM**

**Nr. 603, datë 23.12.2021**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN PARA AFATIT TË SHËRBIMIT NË SKEMËN E DELEGIMIT,  
PËR GJYQTAREN ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “e”, pika 1, të nenit 4 dhe në pikën 4, të neni 14, të Vendimit të tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, në kushtet kur verifikohet që gjyqtarja e skemës së delegimit znj. {...} të jetë ngritur në detyrë dhe caktuar në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Apelit Korçë, ku vijimi i shërbimit në skemë delegimi cenon funksionalitetin e kësaj të fundit, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren znj. {...}.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykatës së Apelit Korçë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**